



**Republika e Kosovës**  
**Republic of Kosovo - Republika Kosova**  
**Qeveria- Government -Vlada**

---

**PROJEKTLIGJ PËR BORXHIN SHETETËROR DHE GARANCITË SHETETËRORE<sup>1</sup>**

**THE DRAFT LAW ON STATE DEBT AND STATE GUARANTEES<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O DRŽAVNOM DUGU I DRŽAVNIM GARANCIJAMA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, është miratuar në mbledhjen e 46 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 04/ më datë 30.11.2021.

<sup>2</sup> Draft Law on State Debt and State Guarantees, was approved on the 46 meeting of the government of kosovo, with the decision no. 04/46, dated 30.11.2021.

<sup>3</sup> Nacrt zakona o Državnom Dugu i Državnim Garancijama, usvojen je na 46 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br. 04/46, datum 30.11.2021.

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në bazë të nenit 65 (1) dhe nenit 120 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR BORXHIN SHETËTOROR DHE GARANCITË SHETËTORE</b></p> <p><b>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Ky ligj rregullon parimet kryesore dhe procedurat e huamarrjes shtetërore, emetimit të garancive shtetërore, pagesave të kryegjësë, interesit, tarifave dhe komisioneve të ndërlidhura me borxhin shtetëror, monitorimin e garancive shtetërore si dhe shpenzimeve tjera të ndërlidhura me to.</p> <p><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Dispozitat e këtij Ligji janë të zbatueshme për të gjitha institucionet dhe entitetet publike në Republikën e Kosovës që</p>	<p><b>Assembly of Republic of Kosovo,</b></p> <p>Pursuant to Article 65 (1) and Article 120 (3) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p><b>LAW ON STATE DEBT AND STATE GUARANTEES</b></p> <p><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>This Law regulates main principles and procedures for state borrowing, issuance of state guarantees, payment of principal, interest, fees and commissions related to the state debt, monitoring state guarantees and other costs related to them.</p> <p><b>Article 2 Scope</b></p> <p>The provisions of this Law shall be applicable to all institutions and public entities in the Republic of Kosovo that are</p>	<p><b>Skupština Republike Kosovo</b></p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKONA O DRŽAVNOM DUGU I DRŽAVNIM GARANCIJAMA</b></p> <p><b>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 1 Svrha</b></p> <p>Ovaj zakon ima za cilj regulisanje osnovnih principa i procedura zaduživanja države, izdavanja državnih garancija, otplate glavnice i kamate , druge tarife i komisije vezane za državni dug monitorisanje pozvanih državnih garancija kao i drugih troškova vezanih sa njima.</p> <p><b>Član 2 Delokrug</b></p> <p>Odredbe ovog zakona su primenljive za sve institucije i javni subjekti u Republici Kosovo koje su uključene i preuzimaju</p>
---	---	---

<p>përfshihen dhe marrin obligime lidhur me borxhin e shtetëror dhe garancive shtetërore sipas dispozitave të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Përkufizimet e përdorura në këtë Ligj kanë kuptimin si në vijim:</p> <p>1.1. <b>Agjent fiskal</b> – nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (këtu e tutje: BQK), e cila vepron si agjent i ministrisë përkatëse për financa për të zbatuar detyra të caktuara që kanë të bëjnë me çështje fiskale të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. <b>Ankand i letrave me vlerë</b> – nënkupton mekanizmin përmes të cilit mundësohet emetimi i letrave me vlerë të qeverisë në konkurrencë të plotë në platformën e autorizuar sipas dispozitave të këtij Ligji;</p> <p>1.3. <b>Borxh i brendshëm</b> – nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar nga kreditor brenda vendit sipas këtij Ligji;</p> <p>1.4. <b>Borxh komunal</b> - nënkupton tërësinë e borxhit të kontraktuar nga komunat Republikës së Kosovës, të cilin e huazojnë përmes Ministrisë sipas</p>	<p>involved and assume obligations regarding state debt and state guarantees, in accordance with the provisions of this Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. The definitions used in this Law have the following meanings:</p> <p>1.1. <b>Fiscal Agent</b> - shall mean the Central Bank of the Republic of Kosovo (hereinafter: the CBK), which acts as an agent of the relevant Ministry of Finance to carry out certain duties related to the fiscal affairs of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. <b>Securities auction</b> - shall mean the mechanism used to enable government securities to be issued in a full competition, using an authorized platform under the provisions of this Law;</p> <p>1.3. <b>Domestic Debt</b> - shall mean a State Debt issued or entered into with a lender within the country under this Law;</p> <p>1.4. <b>Municipal Debt</b> - shall mean the total debt entered into by the municipalities of the Republic of Kosovo, borrowed through the Minister</p>	<p>obaveze u vezi sa državnim dugom i državnim garancijama, u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Definicije korišćeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Fiskalni agent</b> - označava Centralnu banku Republike Kosova (u daljem tekstu: CBK), koja djeluje kao agent relevantnog ministarstva finansija za sprovođenje određenih zadataka koji se odnose na fiskalna pitanja Republike Kosovo;</p> <p>1.2. <b>Aukcija hartija od vrednosti</b> – označava mehanizam kroz koji se omogućava izdavanje vladinih hartije od vrednosti u punoj konkurenciji na ovlašćenoj platformi u skladu sa odredbama ovog zakona;</p> <p>1.3. <b>Unutrašnji dug</b> – označava dug državni dug koji je izdat ili ugovoren sa kreditorime unutar države skladu sa ovim zakonom.;</p> <p>1.4. <b>Opštinski dug</b> - označava celovitost duga koje su ugovarale opštine Republike Kosovo, koji pozajmljuju preko Ministra u skladu sa odredbama utvrđenim u ovom zakonom;</p>
--	--	--

<p>dispozitave dhe rregullave të përcaktuara në këtë Ligj;</p> <p>1.5. <b>Borxh qeveritar</b> – nënkupton tërësinë e borxhit që merret në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (këtu e tutje: Qeveria) sipas dispozitave të këtij Ligji dhe të cilin Qeveria merr përsipër ta paguajë atë;</p> <p>1.6. <b>Borxh shtetëror</b> – nënkupton tërësinë e borxhit qeveritar neto dhe borxhit komunal të marrë sipas dispozitave të këtij Ligji;</p> <p>1.7. <b>Borxhi i jashtëm</b> – nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar përmes marrëveshjes ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjes financiare me kreditor i cili ka seli jashtë vendit;</p> <p>1.8. <b>Garancia shtetërore</b> - nënkupton një marrëveshje garancie e lidhur për një huamarrje të një entiteti publik ose privat, për të cilin Ministria ka emetuar garanci shtetërore sipas këtij Ligji;</p> <p>1.9. <b>Huamarrje</b> – nënkupton procesin e krijimit të obligimeve financiare ose kreditore, përkatësisht borxhit shtetëror, duke hyrë në marrëveshje financiare, marrëveshje ndërkombëtare ose emetim të letrave me vlerë;</p>	<p>subject to the provisions and rules set out in this Law;</p> <p>1.5. <b>Government Debt</b> - shall mean the total debt issued on behalf of the Government of the Republic of Kosovo (hereinafter: the Government), under the provisions of this Law, and which the Government undertakes to repay;</p> <p>1.6. <b>State Debt</b> - shall mean the total government net debt and municipal debt borrowed under the provisions of this Law;</p> <p>1.7. <b>External Debt</b> -shall mean the state debt issued or entered into under the provisions of this Law, by means of international agreement and/or financial agreements with a lender incorporated abroad;</p> <p>1.8. <b>State Guarantee</b> - a guarantee agreement issued for a loan of a public or private entity for which the Ministry has issued state guarantees under this Law;</p> <p>1.9. <b>Borrowing</b> - shall mean the process of creating financial or credit obligations, namely state debt, by entering into financial agreements, international agreements or issuing securities;</p>	<p>1.5. <b>Dug Vlade</b> – označava celokupni dug koji se uzima u ime Vlade Republike Kosovo (u daljem tekstu: Vlada) u skladu sa odredbama ovog zakona za koji se Vlada obavezuje da ga plati;</p> <p>1.6. <b>Državni dug</b> – označava celokupni dug vlade i opštinski dug koji je uzet u skladu sa odredbama ovog zakona;</p> <p>1.7. <b>Strani dug</b> – označava državni dug koji je izdat ili ugovoren, putem međunarodnih sporazuma , ili finansijskih sporazuma sa kreditorima cije je sediste u inostranstvu.</p> <p>1.8. <b>Državna garancija</b> - označava sporazum garantiranja sklapano za pozajmljivanje ili za neki projekat nekog javnog ili privatnog entiteta za koje je Ministarstvo izdalo državne garancije u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.9. <b>Pozajmica</b> – označava proces stvaranja finansijskih ili kreditnih obaveza, odnosno državnog duga, sklapanjem finansijskih ugovora, međunarodnih ugovora ili izdavanjem hartija od vrednosti;</p> <p>1.10. <b>Institucije i drugi javni subjekti</b> – označava sve javne institucija van</p>
--	--	---

<p>1.10. <b>Institucionet dhe entitetet tjera publike</b> – nënkupton të gjitha institucionet publike jashtë Qeverisë dhe komunave të Republikës së Kosovës, të themeluara sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, që ushtrojnë veprimtarinë në Kosovë në të dy nivelet e organizimit, përjashtuar BQK-në;</p> <p>1.11. <b>Kontraktim i drejtpërdrejt (plasim direkt)</b> - nënkupton procesin e emetimit të letrave me vlerë i cili nuk zhvillohet përmes ankandit publik por zhvillohet nëpërmjet plasimit direkt, përkatësisht kontraktimit të drejtpërdrejtë të investitorëve institucional;</p> <p>1.12. <b>Letra me vlerë të Qeverisë</b> – nënkupton instrumentin e borxhit shtetëror të emetuar në bazë të interes – bartjes, me bazë zbritjeje, të indeksuara, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara përmes kalendarit të emetimit të letrave me vlerë;</p> <p>1.13. <b>Marrëveshja për nën-huazim</b> – nënkupton marrëveshjen e cila i rregullon kushtet dhe afatet për një hua paraprakisht të marrë nga Ministria për një huamarrës të fundit në Republikën e Kosovës sipas dispozitave të këtij Ligji;</p> <p>1.14. <b>Marrëveshje derivative financiare</b>– nënkupton marrëveshjen</p>	<p>1.10. <b>Institutions and other public entities</b> - shall mean all public institutions outside the Government and municipalities of the Republic of Kosovo, established under the Constitution and laws of Kosovo, exercising their activity in Kosovo at both levels of the organization, excluding the CBK;</p> <p>1.11. <b>Direct offering (private placement)</b> - shall mean the process of issuing securities, not conducted through public auction but via direct placement, respectively the direct contracting of institutional investors;</p> <p>1.12. <b>Government Securities</b> - shall mean instruments of state debt issued on an interest-bearing basis, on a discount basis, indexed under terms and conditions determined pursuant to the issuance calendar for securities;</p> <p>1.13. <b>On-Lending Agreement</b> - shall mean an agreement stipulating terms and conditions for a loan previously taken by the Ministry for the last borrower in the Republic of Kosovo under the provisions of this Law;</p> <p>1.14. <b>Derivative financial agreement</b> - shall mean a financial agreement</p>	<p>Vlade i opština Republike Kosova, osnovane u skladu sa Ustavom i zakonima Kosova, koje obavljaju delatnost na Kosovu na oba nivoa organizacije, izuzev CBK;</p> <p>1.11. <b>Direktno ugovaranje (direktan plasman)</b> - označava proces izdavanja hartija od vrednosti koji se ne provodi putem javne aukcije, već se provodi putem direktnog plasiranja, odnosno, direktnog ugovaranja institucionalnog investitora;</p> <p>1.12. <b>Hartija od vrednosti Vlade</b> – označava instrument državnog duga koji se izdaje na osnovu prenosa-kamate, sa osnovom smanjenja, indeksirane prema uslovima i rokovima određenim putem kalendara izdavanja hartija od vrednosti;</p> <p>1.13. <b>Sporazum o podzajmu</b> – označava sporazum koji regulise uslove i pravila za zajam koji je prethodno pozajmljen od Ministarstva za zadnjeg zajmoprimca u Republici Kosovo, u skladu sa odredbama ovog zakona;</p> <p>1.14. <b>Derivatívni finansijski sporazum i druge standardizovane finansijske transakcije</b> – označava finansijski sporazum za finansijske instrumente sa</p>
--	--	---

<p>financiare për instrumentet financiare me qëllim të menaxhimit të rrezikut të ndryshimit të normës së interesit, çmimit të instrumentit financiar, kursin e këmbimit valutor, rrezikun e kredisë dhe rreziqe të ngjashme;;</p> <p><b>1.15. Marrëveshje financiare</b> – nënkupton marrëveshjen të lidhur sipas legjislacionit në fuqi, e cila rregullon afatet dhe kushtet në bazë të të cilave huamarrësi ka marrë fonde nga huadhënësi pavarësisht nga selia e tij, dhe që përfshin dispozitat të cilat rregullojnë shlyerjen e tyre;</p> <p><b>1.16. Marrëveshje ndërkombëtare</b> – nënkupton marrëveshjen ndërkombëtare të lidhur me shtete dhe organizata financiare ndërkombëtare, e cila ratifikohet, dhe e cila i rregullon afatet dhe kushtet në bazë të të cilave huamarrësi ka marrë fonde nga huadhënësi sipas dispozitave të këtij Ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare;</p> <p><b>1.17. Menaxhimi i borxhit shtetëror</b> - nënkupton procesin nga negociimi i marrëveshjes së financimit apo marrëveshjes ndërkombëtare, emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë, shërbimi i borxhit shtetëror duke përfshirë parapagimin apo ri-blerjen, regjistrimin, validimin, dhe raportimin e borxhit shtetëror;</p>	<p>concluded for a financial instrument with the purposes of managing the fluctuation risks of the interest rates, financial instrument prices, commodity prices, foreign exchange rates, credit risk and other similar risks;</p> <p><b>1.15. Financial Agreement</b> - shall mean an agreement concluded under the legislation in force, which sets out the terms and conditions on the basis of which the borrower has received funds from the lender regardless of its place of incorporation, and which includes the provisions governing their repayment;</p> <p><b>1.16. International Agreement</b> - shall mean the ratified international agreement concluded with states and international financial organizations, which sets out the terms and conditions on the basis of which the borrower has received funds from the lender under the provisions of this Law and the relevant legislation in force for international agreements;</p> <p><b>1.17. State Debt Management</b> - shall mean the process from negotiating a financing agreement or an international agreement, issuance of government securities, servicing including pre-payment or buy-back, recording, validating, and reporting state debt;</p>	<p>ciljem upravljanja rizikom promene kamatne stope , cene finansijskog instrumenta , kursa razmene valute , kreditnog rizika i slicnih rizika.;</p> <p><b>1.15. Finansijski sporazum</b> – označava sporazum zaključen na osnovu važećeg zakonodavstva koji regulise rokove i uslove na osnovu kojih je zajmoprimac primio sredstva od zajmodavca bez obzira od njegovog sedista i sadrži odredbe koje regulišu njihovu otplatu;</p> <p><b>1.16. Međunarodni sporazum</b> – označava međunarodni sporazum koji je zaključen i ratifikovan sa drzavama i finansijskim organizacijama koja regulise rokove i uslove na osnovu kojih je zajmoprimac primio sredstva od zajmodavca u skladu sa odredbama ovog zakona i relevantnog zakonodavstva koji je na snazi za međunarodne sporazume;</p> <p><b>1.17. Upravljanje državnim dugom</b> - označava proces od pregovora o finansijskom sporazumu ili međunarodnog finansijskog sporazuma do servisiranja, registracije, validacije, konsolidacije i raportiranja državnog duga;</p>
---	---	--

<p>1.18. <b>Ministri</b> – nënkupton ministrin përkatës për financa, si i autorizuar i vetëm për huamarrje shtetërore dhe emetimin e garancive shtetërore sipas këtij Ligji;</p> <p>1.19. <b>Ministria</b> – nënkupton ministrinë përkatëse të financave të Qeverisë, e cila për qëllim të këtij Ligji vepron vetëm nëpërmjet Ministrit;</p> <p>1.20. <b>Parapagim</b> – nënkupton pagesën e parakohshme të pjesshme apo të plotë të kredisë të marrë sipas këtij Ligji;</p> <p>1.21. <b>Periudha e pritjes (grejs periudha)</b> – periudha gjatë të cilës nuk paguhet kryegjëja e kredisë sipas marrëveshjes për kredi dhe planit të pagesave;</p> <p>1.22. <b>Ri-financim i borxhit</b> – nënkupton huamarrjen me qëllim të sigurimit të mjeteve për pagimin e borxhit ekzistues apo që ka maturuar dhe që duhet të ri-financohet;</p> <p>1.23. <b>Shërbim i borxhit shtetëror</b> – nënkupton pagesat që duhet kryer brenda çdo viti fiskal për kryegjënë, interesat, zbritjet (diskontin) dhe pagesat e tjera që duhet paguar për borxhin shtetëror, përfshirë shpenzimet e ndërlidhura;</p>	<p>1.18. <b>Minister</b> - shall mean the relevant minister of finance, as the sole authority to engage in state borrowing and issue state guarantees under this Law;</p> <p>1.19. <b>Ministry</b> - shall mean the respective Ministry of Finance of the Government, which for the purpose of this Law shall act only through the Minister;</p> <p>1.20. <b>Prepayment</b> - shall mean early repayment of the loan borrowed under this Law, in part or in full;</p> <p>1.21. <b>Grace period</b> - the period during which the principal of the loan is not paid according to the loan agreement and the payment schedule;</p> <p>1.22. <b>Debt re-financing</b> - shall mean borrowing for the purpose of obtaining funds for the repayment of existing debt or maturing debt to be re-financed;</p> <p>1.23. <b>State Debt service</b> – shall mean payments to be made within each fiscal year for the principal, interest, discounts and other payments to be paid for state debt, including related costs;</p>	<p>1.18. <b>Ministar</b> – označava relevantnog ministra za finansije kao jedini ovlašćen za državno zaduživanje i izdavanje državnih garancija po ovom zakonu;</p> <p>1.19. <b>Ministarstvo</b> – označava odgovarajuće ministarstvo finansija Vlade, koja za potrebe ovog zakona postupa isključivo preko ministra;</p> <p>1.20. <b>Avansna uplata</b> - označava delimičnu ili potpunu isplatu kredita dobijenog u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.21. <b>Period čekanja (grace period)</b> – period u kojem glavnica kredita nije plaćena prema sporazumu o kreditu i planu plaćanja;</p> <p>1.22. <b>Ponovno finansiranje duga</b> – označava pozajmljivanje u cilju obezbeđivanja sredstava za plaćanje postojećeg ili dospelog duga i treba se ponovo finansirati;</p> <p>1.23. <b>Servisiranje duga</b> – označava isplate koje treba izvršiti u svakoj fiskalnoj godini za glavicu, kamate, popuste (diskont) i druga plaćanja koje treba platiti za državni dug, uključujući i troškove povezane sa tim;</p>
--	---	---

<p>1.24. <b>Tregu primar</b> – nënkupton emetimin fillestar të letrave me vlerë të Qeverisë nga Ministria; dhe</p> <p>1.25. <b>Tregu sekondar</b> – nënkupton tregtimin e letrave me vlerë të Qeverisë pas emetimit fillestar;</p> <p>2. Të gjitha përkufizimet tjera që nuk janë përcaktuar në këtë Ligj, do të jenë të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike.</p>	<p>1.24. <b>Primary Market</b> – shall mean the initial issuance of Government Securities by the Ministry; and</p> <p>1.25. <b>Secondary Market</b> – the trading of Government Securities after their initial issuance;</p> <p>2. All other definitions not included in this Law shall be understood according to the legislation in force for public financial management.</p>	<p>1.24. <b>Primarno tržište</b> – označava početno izdavanje hartija od vrednosti od strane Ministarstva; i</p> <p>1.25. <b>Sekundarno tržište</b> – označava trgovanje državnim hartijama od vrednosti nakon početnog izdavanja;</p> <p>2. Sve ostale definicije koje nisu definisane u ovom Zakonu, će biti važeća prema važećem zakonodavstvu za upravljanje javnim finansijama.</p>
<p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI II BORXHI SHTETËROR</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>CHAPTER II STATE DEBT</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE II DRŽAVNI DUG</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Tërësia e borxhit shtetëror</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4 State debt composition</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4 Celokupnost duga države</b></p>
<p>1. Borxhi shtetëror përbëhet nga borxhi qeveritar dhe borxhi komunal.</p> <p>2. Borxhi qeveritar përbëhet nga letrat me vlerë të emetuara, marrëveshjet ndërkombëtare dhe marrëveshjet financiare që i nënshtrohen legjislacionit vendor apo të huaj.</p> <p>3. Borxhi komunal përfshin borxhin e kontraktuar përmes marrëveshjes ndërkombëtare apo marrëveshjes financiare që i nënshtrohet legjislacionit vendor apo të huaj.</p>	<p>1. State debt consists of government debt and municipal debt.</p> <p>2 Government debts consists of securities issued, international agreements and financial agreements subject to domestic or foreign legislation.</p> <p>3. Municipal debt includes debt entered through an international agreement or financial agreement that is subject to domestic or foreign legislation.</p>	<p>1. Državni dug obuhvata i sastavlja se od duga vlade i opštinskog duga.</p> <p>2. Vladin dug se sastavlja od izdatih hartija od vrednosti, međunarodne sporazume i finansijske sporazume koji podležu domaćim ili stranim zakonodavstvima.</p> <p>3. Opštinski dug uključuje dug koji je ugovoren međunarodnim sporazumom ili finansijskim sporazumom koji podleže domaćem ili stranom zakonodavstvu.</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Format e borxhit shtetëror</b></p> <p>1. Borxhi shtetëror mund të realizohet në formë të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>2. Borxhi i brendshëm mund të realizohet përmes emetimit të letrave me vlerë si dhe marrëveshjeve financiare të realizuara me kreditorë me seli vendore.</p> <p>3. Borxhi i jashtëm mund të realizohet përmes emetimit të letrave me vlerë në tregjet ndërkombëtare, marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe marrëveshjeve financiare me kreditorë me seli të huaj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Forms of State debt</b></p> <p>1. State debt is carried out as a domestic and external debt.</p> <p>2. Domestic debt may be carried out by issuing securities as well as through financial agreements concluded with creditors incorporated domestically.</p> <p>3. External debt may be carried out by issuing securities in international markets, by international agreements and by financial agreements with a creditor incorporated abroad.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Oblici državnog duga</b></p> <p>1. Državni dug se može ostvariti u obliku domaćeg i stranog duga.</p> <p>2. Unutrašnji dug se može ostvariti izdavanjem hartija od vrednosti, kao i finansijskim sporazumima ostvarenim u skladu sa zakonodavstvom Republike Kosovo.</p> <p>3. Međunarodni dug se može ostvariti izdavanjem hartija od vrednosti na međunarodnim tržištima. I finansijskim sporazumima sa dužnicima koji imaju strano sediste.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Kufizimet e borxhit shtetëror</b></p> <p>Shuma e borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore planifikohet dhe paraqitet në kuadër të ligjit vjetor për ndarje buxhetore.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>State Debt Restrictions</b></p> <p>The total state debt amount and state guarantee amount shall be projected and stipulated within the annual appropriations budget law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Ograničenje državnog duga</b></p> <p>Godišnja suma državnog duga određuje se i planifikuje se u okviru zakona o godišnjem budžetu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Autorizimi për huamarrje</b></p> <p>1. Ministria ka autoritetin e vetëm për të negociuar dhe marrë borxh shtetëror në</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Authorisation to Borrow</b></p> <p>1. The Ministry has the sole authority to negotiate and borrow state debt on behalf of</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Ovlašćenje za zaduživanje</b></p> <p>1. Jedino ministarstvo ima autoritet da uzme državni dug u ime Republike Kosovo, preko</p>

<p>emër të Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë përkatëse për financa, si i autorizuar i vetëm pa të drejtë delegimi të këtij autorizimi.</p> <p>2. Ministri është i autorizuar të negociojë dhe lidh marrëveshje të nevojshme për të mundësuar emetimin e letrave me vlerë në tregjet ndërkombëtare.</p> <p>3. Asnjë institucion tjetër publik në Republikën e Kosovës nuk mund të merr borxh shtetëror në emër të Republikës së Kosovës sipas dispozitave të këtij ligji.</p>	<p>the Republic of Kosovo, through the relevant Minister of Finance, as the only authorized person, without the right to delegate such authorization.</p> <p>2. The Minister is authorized to negotiate and conclude necessary agreements which enables the issuance of securities in international markets.</p> <p>3. No other public institution in the Republic of Kosovo shall be entitled to incur state debt, on behalf of the Republic of Kosovo, according to the provisions of this Law</p>	<p>relevantnog ministra za finansije, kao jedina ovlašćena osoba bez prava delegiranja ovog ovlašćenja.</p> <p>2. Nijedna druga javna institucija u Republici Kosovo ne može uzeti državni dug u skladu sa odredbama ovog zakona u ime Republike Kosovo.</p> <p>3. Ni jedna druga javna institucija u Republici Kosovo ne može da uzme državni dug u ime Republike Kosovo u skladu sa odredbama ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Kushtet e borxhit shtetëror</b></p> <p>1. Borxhi shtetëror mund të kontraktohet ose emetohet me normë fikse ose të ndryshueshme të interesit.</p> <p>2. Borxhi i brendshëm mund të emetohet vetëm në valutën zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Borxhi i jashtëm mund të emetohet në valutën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe valuta të tjera të huaja, duke i marrë për bazë prioritetet afatmesme të rrezikut valutës të vendosura në strategjinë e menaxhimit të borxhit shtetëror.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>State Debt Terms</b></p> <p>1. State debt may be entered into or issued at a fixed or variable interest rate.</p> <p>2. Domestic debt may be issued only in the official currency of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. External debt may be issued in the official currency of the Republic of Kosovo, as well as other foreign currencies, having into account the medium-term priorities of currency risk in the state debt management strategy.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Uslovi državnog duga</b></p> <p>1. Državni dug se može ugovarati ili izdati po fiksnoj ili varijabilnoj kamatnoj stopi.</p> <p>2. Unutrašnji dug se može izdati samo u zvaničnoj valuti Republike Kosovo.</p> <p>3. Strani dug se može izdati u zvaničnoj valuti Republike Kosovo, kao i u druge strane valute, prema kriterijumima određenim pod zakonskim aktom Ministra bazirajući se u srednje rokovne prioritete supostavljene u strategiji menadžiranja državnog duga.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Programi i Borxhit Shtetëror</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>State Debt Program</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Program državnog duga</b></p>
<p>1. Ministria përgatit dhe publikon Programin e Borxhit Shtetëror (këtej e tutje: PBSH), program ky tre (3) vjeçar, dhe i cili rishikohet së paku një (1) herë në vit, me anë të së cilit përcaktohen objektivat, orientimet dhe masat për menaxhimin e borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, me qëllim të sigurimit të financimit adekuat, me kosto dhe rrezik sa më të ultë.</p> <p>2. PBSH aprovohet nga Qeveria dhe i dërgohet për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës (këtu e tutje: Kuvendi), jo më vonë se tridhjetë (30) prill të vitit vijues. Pas kësaj date, PBSH mund të përditësohet në varësi të zhvillimeve të kornizës makroekonomike të vendit.</p> <p>3. PBSH përmban por duke mos u kufizuar elementet si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. Objektivat e menaxhimit të borxhit shtetëror;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. Karakteristikat e portofolit të borxhit shtetëror;</p>	<p>1. The Ministry shall prepare and publish the State Debt Program (hereinafter referred as: SDP), a three (3) year rolling program, reviewed at least once a year, which sets out the objectives, guidelines and measures for managing state debt and state guarantees under the best international standards for the purpose of securing adequate funding at the lowest cost and risk possible.</p> <p>2. The SDP is approved by the Government and submitted to the Assembly of the Republic of Kosovo (hereinafter: the Assembly) for their information no later than thirtieth (30) of April of the following year. After this date, SDP can be updated depending on the developments of the country's macroeconomic framework.</p> <p>3. The SDP shall contain the elements including but not limited to the following:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. Objectives of state debt management;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. Characteristics of the state debt portfolio;</p>	<p>1. Ministarstvo priprema i objavljuje PDD (), ovaj trogodišnji (3) program, koji se revidira 1 godisnje kojim se određuju ciljevi, orijentisanja i mere za upravljanje državnim dugom i drzavnim garancijama prema najboljim međunarodnim standardima u cilju obezbeđivanja adekvatnog finansiranja, sa što manjim troškovima i rizikom.</p> <p>2. PDD se odobrava od Vlade i prosleđuje se za informisanje Skupštini Republike Kosovo (u daljem tekstu: Skupština) za najkasnije do trideset-og (30) aprila naredne godine. Nakon tog datuma, PDD se može ažurirati u zavisnosti od razvoja makro-ekonomskog okvira zemlje.</p> <p>3. PDD sadrži ali se ne granici na sledece elemente:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. Ciljevi upravljanja državnim dugom;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. Karakteristike portfelja državnog duga;</p>

<p>3.3. Zhvillimet dhe rreziqet kryesore makroekonomike;</p> <p>3.4. Analizat e rreziqeve kryesore që lidhen me strukturën e borxhit shtetëror;</p> <p>3.5. Identifikimin e nevojave dhe burimeve të financimit bazuar në kornizën afatmesme të shpenzimeve;</p> <p>3.6. Planifikimin strategjik afatmesëm të borxhit; dhe</p> <p>3.7. Të dhëna tjera të rëndësishme/relevante.</p> <p>4. PBSH është dokumenti kryesor dhe shërben si bazë për procesin e huamarrjes sipas dispozitave të këtij Ligji, i cili paraqet udhëzimet kryesore rreth limiteve dhe kushteve të borxhit shtetëror. Asnjë proces i planifikimit për huamarrje, apo huamarrjes në vetvete, apo ndonjë veprim i cili bie ndesh me PBSH nuk mund të ndërmerret.</p> <p>5. Ministri paraqet para Kuvendit raportin për nivelin e borxhit shtetëror dhe garancitë shtetërore në baza vjetore, duke përfshirë realizimin e projekteve të huamarrjes si dhe përmbushjen e objektivave të PBSH-së, i cili do të jetë i qasshëm publikisht.</p>	<p>3.3. Main macroeconomic developments and risks;</p> <p>3.4. Analysis of the major risks associated with the state debt structure;</p> <p>3.5. Identifying funding needs and resources based on the medium term fiscal framework;</p> <p>3.6. Medium-term debt strategic planning; and</p> <p>3.7. Other important/relevant information.</p> <p>4. SDP is the main document and serves as the basis for the borrowing process under the provisions of this Law, which includes main guidelines regarding the limitations and conditions of the state debt. No borrowing projections, borrowing in itself, or any action that is inconsistent with SDP shall not be undertaken.</p> <p>5. The Minister shall present annually to the Assembly the report on the level of state debt and state guarantees, by including the realization of the project financing, as well as the fulfilment of the SDP's objectives, and should be publicly available.</p>	<p>3.3. Glavna makro-ekonomska kretanja i rizike;</p> <p>3.4. Analize glavnih rizika vezani za strukturu državnog duga;</p> <p>3.5. Identifikacija potreba i izvora finansiranja bazirajući se na srednjeročni okvir trsokova;</p> <p>3.6. Srednjoročno strateško planiranje duga; i</p> <p>3.7. Drugi važni podaci / relevantni .</p> <p>4. PDD je glavni dokument i služi kao osnova za proces zaduživanja prema odredbama ovog Zakona, koji predstavlja glavne upute oko ograničenja i uslove državnog duga . Nijedan proces zaduživanja ili zaduživanja u samom sebi ili bilo kakva akcija koja bi mogla biti u sukobu sa PDD - om ne može se preduzeti.</p> <p>5. Ministar u Skupštini izvestaj o nivou državnog duga i državnih garancija nga godisnje baze , obuhvatajući realizaciju projekte dugovanja i o ispunjenju ciljeva PDD-a kjo ce biti javno pristupacni.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Menaxhimi i borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore</b></p> <p>1. Thesari i Kosovës (këtej e tutje: Thesari) në kuadër të Ministrisë është përgjegjës për menaxhimin e borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore.</p> <p>2. Në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, Thesari autorizohet të hyjë në marrëveshje derivative financiare, me qëllim të menaxhimit të kostos dhe mbrojtjes nga ekspozimi ndaj rreziqeve të portofolit të borxhit shtetëror.</p> <p>3. Thesari mund të bëjë ri-blerjen dhe parapagimin e borxhit shtetëror me qëllim të menaxhimit më efikas të portofolit të borxhit shtetëror, në përputhje me objektivat e përcaktuara në PSh.</p> <p>4. Procedurat e menaxhimit të borxhit shtetëror rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>State Debt and State Guarantees Management</b></p> <p>1. Kosovo Treasury (hereinafter: the Treasury) within the Ministry is responsible for managing state debt and state guarantees.</p> <p>2. In accordance with paragraph 1 of this Article, the Treasury is authorized to enter into derivative financial arrangements in order to manage the cost and mitigate the risk exposure of the state debt portfolio.</p> <p>3. The Treasury may buy-back and prepay the state debt in order to manage the state debt portfolio more efficiently in accordance with the objectives set out in the SDP.</p> <p>4. State debt management procedures are regulated by a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Upravljanje državnim dugom i državnim garancijama</b></p> <p>1. Trezor Kosova (ndalje u tekstu : Trezor) u okviru Ministarstva je odgovoran za upravljanje državnim dugom i državnim garancijama.</p> <p>2. U skladu sa stavom 1. ovog člana, Trezor je ovlašćen da zaključuje derivativne finansijske sporazume finansijske transakcije u cilju menadjiranja troškova i odbrane od ekspoziranaj prema rizicima portfelja državnog duga.</p> <p>3. Trezor može izvršiti ponovnu kupovinu i avansno plaćanje državnog duga u cilju efikasnijeg upravljanja portfeljom državnog duga, u skladu sa ciljevima utvrđenim u PDD -u.</p> <p>4. Procedure za upravljanje državnim dugom su regulisane podzakonskim aktom od strane ministra.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Shërbimi i borxhit shtetëror</b></p> <p>1. Shërbimi i borxhit shtetëror ka prioritetin më të lartë të pagesës në raport me shpenzimet tjera publike.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>State debt service</b></p> <p>1. State debt service has the highest priority in terms of payment in relation to other public expenditures.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Servisiranje državnog duga</b></p> <p>1. Sluzba državnog duga ima najveći prioritet isplate na odnosu sa drugim javnim troškovima</p>

<p>2. Shuma e nevojshme për të përmbushur obligimet ndaj pagesës së kryegjësë, interesit dhe tarifave tjera në emër të shërbimit të borxhit shtetëror parashikohet në kuadër të ligjit vjetor për ndarje buxhetore.</p> <p>3. Në rast se shuma e parashikuar është e pamjaftueshme për të kryer në tërësi detyrimet për shërbimin e borxhit shtetëror, Thesari mund të kryejë pagesën e plotë ose diferencën e mbetur nga Llogaria e Vetme e Thesarit.</p> <p>4. Në rast të pagesës nga Llogaria e Vetme e Thesarit sipas paragrafit 3 të këtij neni, brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga data e pagesës, Thesari përgatit një raport lidhur me arsyet për tejkalim të parashikimeve buxhetore, i dorëzon Ministrit dhe shpalos atë në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. E njëjta informatë përfshihet në raportimin sipas paragrafit 5 të nenit 9 të këtij ligji.</p>	<p>2. The amount needed to meet the obligations to pay the principal, interest and other fees on behalf of the state debt service is provided under the annual appropriations budget law.</p> <p>3. If the estimated amount is insufficient to fully meet the obligations for servicing the State Debt, the Treasury may make the full payment or the remaining difference from the Treasury Single Account.</p> <p>4. In the event of payment from the Treasury Single Account as provided for in paragraph 3 of this Article, within forty five (45) days from the date of payment, the Treasury shall prepare a report on the reasons for exceeding the budgetary projections, submits the report to the Minister and discloses the information within the annual financial statements. The same information shall be included in the reporting according to paragraph 5 of article 9 of this Law.</p>	<p>2. Iznos potreban za ispunjenje obaveza za plaćanje glavnice, kamata i drugih naknada u ime servisiranja državnog duga predviđa se u okviru godišnjeg zakona o budžetnim odredjivanjima</p> <p>3. Ako predviđeni iznos je nedovoljan da u potpunosti ispuni obaveze za servisiranje državnog duga, Trezor može izvršiti punu uplatu ili preostalu razliku iz jedinog ziroacuna Trezora</p> <p>4. U slučaju plaćanja iz jedinog ziroacuna Trezora prema stavu 3. ovog člana, u roku od 45 dana od dana uplate, Trezor priprema izveštaj o razlozima za prekoračenje budžetskih predviđanja, dostavlja ga ministru i objavljuje ga u okviru godišnjih finansijskih izveštaja. Ista se informacija obuhvaća i u izveštavanju prema stavu 5 člana 9 ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Pariteti i borxhit shtetëror</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Parity of State debt</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Paritet državnog duga</b></p>
<p>1. Borxhi shtetëror ka paritet dhe barazi të statusit (<i>pari passu</i>), pavarësisht formës dhe periudhës së marrjes së borxhit.</p> <p>2. Pretendimi lidhur me pagesën e kryegjësë, interesit dhe tarifave tjera të</p>	<p>1. State Debt shall have parity and equality of status (<i>pari passu</i>), regardless the period and format of debt acquisition.</p> <p>2. Claims regarding the payment of the principal, interest and other fees applicable</p>	<p>1. Državni dug ima paritet i jednakost statusa (<i>pri passu</i>), nezavisno od oblika i perioda uzimanja duga.</p> <p>2. Tvrdnja u vezi sa isplatom glavnice, kamate i drugih primenjivih naknada</p>

<p>aplikueshme të borxhit shtetëror përbën pretendimin e parë kundrejt Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe nuk do të jetë i varur nga asnjë pretendim tjetër.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI III MENAXHIMI I KUFIRIT TË BORXHIT SHTETËROR</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13 Kufiri i borxhit shtetëror</b></p> <p>1. Kufiri i përgjithshëm i borxhit shtetëror nuk mund të tejkalojë nivelin e përcaktuar me ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike.</p> <p>2. Për qëllim të kalkulimit të kufirit të borxhit shtetëror sipas paragrafit 1 të këtij neni, të gjitha garancitë shtetërore të emtuara dhe në fuqi konsiderohen pjesë përbërëse e këtij kufiri.</p> <p>3. Kufiri i borxhit shtetëror llogaritet dhe raportohet si përqindje e shumës së papaguar të borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore në raport me bruto prodhimin vendor të publikuar në ligjin vjetor për ndarje buxhetore në fuqi në kohën e raportimit.</p>	<p>to State Debt charges constitute the first claim against the Treasury Single Account and shall not be dependent on any other claim.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER III STATE BUDGET CEILING MANAGEMENT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13 State Budget Ceiling</b></p> <p>1. The total State Debt Ceiling may not exceed the level as stipulated in the public financial management law.</p> <p>2. For the purpose of calculating the state debt ceiling under paragraph 1 of this Article, all state guarantees issued and in force shall be considered an integral part of this ceiling.</p> <p>3. The state debt ceiling is calculated and reported as a percentage of the outstanding amount of state debt and state guarantees vis-à-vis the Gross Domestic Product published in the annual appropriations budget law in force at the time of reporting.</p>	<p>državnog duga predstavlja prvu tvrdnju protiv jedinstvenog računa Trezora i neće biti zavisan od bilo koje druge tvrdnje.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE III UPRAVLJANJE GRANICOM DRŽAVNO DUGA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13 Granica državnog duga</b></p> <p>1. Opšta granica državnog duga ne može preći nivo naveden vazecim zakonom za menadžiranje javnih finansija.</p> <p>2. U cilju izračunavanja granice državnog duga iz stava 1. ovog člana, sve državne garancije koje su izdate i koje su na snazi smatraju se sastavnim delom ove granice.</p> <p>3. Granica državnog duga se izračunava i izveštava kao procenat neplaćenog iznosa državnog duga i izdatih državnih garancija i na snazi u odnosu na bruto domaći proizvod objavljen u Zakonu o godišnjem budžet za podeljivanja u koji je na snazi u vreme izveštavanja.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Tejkalimi i Përkohshëm i Kufirit të Borxhit Shtetëror</b></p> <p>Tejkalimi i përkohshëm i kufirit të borxhit shtetëror, duke përfshirë rrethanat, kushtet dhe veprimet e nevojshme për të rikthyer dhe mirëmbajtur nivelin e borxhit shtetëror brenda kufirit, lejohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligjin për menaxhimin e financave publike.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI IV</b> <b>KONTRAKTIMI DHE EMETIMI I BORXHIT SHTETËROR</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Mënyrat e hyrjes në borxh shtetëror</b></p> <p>1. Huamarrja realizohet në format si në vijim:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1.Marrëveshje Financiare;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2.Marrëveshje Ndërkombëtare; dhe</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3.Letra me vlerë të Qeverisë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Temporary Excess of State Debt Ceiling</b></p> <p>Temporary excess of state debt ceiling, including circumstances, conditions and necessary actions to restore and maintain the state debt level within the ceiling applicable, shall be allowed only if is stipulated specifically in the public financial management law.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER IV</b> <b>ENTERING AND ISSUANCE OF STATE DEBT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Methods of entering into a state debt</b></p> <p>1. The borrowing occurs through the following forms:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1.Financial Agreement(s);</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2.International Agreement(s); and</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3.Government Securities.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Privremeno prekoračenje gornje granice državnog duga</b></p> <p>Prekoracenje grancia drzavnog duga ukljucujuci i okolnosti i uslove i potredne mere da bi se dravni dug vratio i odrzao unutar granica , to je dozvoljeno samo ako je izricito je predvidjen sa zakonom of menadjirnaju javnim finansijama.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE IV</b> <b>UGOVARANJE I IZDAVANJE DRŽAVNOG DUGA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Nacini ulaska u državni dug</b></p> <p>1. Pozajmljivanje se realizuje:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1 Finansijskim Sporazumom</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2 Medjunarodnim Sporazumom i</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3 Vladinim hartijama vrednosti.</p>
---	---	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Kontraktimi i borxhit shtetëror përmes marrëveshjeve financiare</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Entering into a state debt through financial agreements</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Ulazak u državni dug putem finansijskih ugovora</b></p>
<p>1. Hyrja në borxh shtetëror përmes marrëveshjeve të financimit si borxh i brendshëm ose i jashtëm realizohet vetëm nëpërmjet Ministrisë.</p> <p>2. Projektet të cilat financohen përmes marrëveshjeve financiare janë nën përgjegjësinë e plotë të organizatës buxhetore ose përfituesit të projektit lidhur me ekzekutimin si dhe mbikëqyrjen e plotë të zbatimit të tyre. Organizata buxhetore dhe entiteti përfitues i financimit merr pjesë në çdo fazë të procesit të sigurimit të financimit.</p> <p>3. Organizatat buxhetore apo entitetet zbatuese të projekteve me marrëveshje financiare, nuk mund të themelojnë Njësi Zbatuese e Projektit (këtu e tutje: NjZP) e cila financohet me fonde të huamarrjes.</p> <p>4. Procedura e kontraktimit dhe amendamentimit të marrëveshjes financiare, zhvillohet përmes procesit konkurrues për lidhjen e kontratës për shërbime dhe realizohet sipas aktit nënligjor të nxjerrë nga Ministri. Marrëveshja financiare e arritur sipas këtij paragrafi aprovohet dhe nënshkruhet nga Ministri.</p>	<p>1. State debt incurred under financing agreement(s), either domestic or external debt, is borrowed only through the Ministry.</p> <p>2. Projects financed through financial agreements are under full responsibility of the budget organization or project beneficiary for the implementation and supervision of the project. The budget organization and the beneficiary of the funding shall be involved in every stage of the financing securing process.</p> <p>3. The Budget Organizations or implementing entities of financial agreement projects, shall not establish a Project Implementation Unit (hereinafter: PIU) which is financed through loan proceeds.</p> <p>4. The procedure for entering into and amending a financial agreement, shall be conducted through a competitive procedure as a service contract which is carried out according to the sub-legal act as issued by the Minister. The financial agreement reached under this paragraph is approved and signed by the Minister.</p>	<p>1. Državni dug nastao po osnovu ugovora o finansiranju, bilo unutrašnjeg ili spoljnog duga, zadužuje se samo preko Ministarstva.</p> <p>2. Projekti finansirani putem finansijskih sporazuma su pod punom odgovornošću budžetske organizacije ili korisnika projekta za implementaciju i nadzor projekta. Budžetska organizacija i korisnik sredstava biće uključeni u svaku fazu procesa obezbeđivanja finansiranja.</p> <p>3. Budžetske organizacije ili subjekti za implementaciju projekata finansijskih sporazuma neće osnivati Jedinicu za implementaciju projekta (u daljem tekstu: PIU) koja se finansira iz sredstava zajma.</p> <p>4. Procedura za sklapanje i izmenu finansijskog sporazuma, sprovodi se kroz konkursnu proceduru kao ugovor o uslugama koji se sprovodi u skladu sa podzakonskim aktom donetim od strane ministra. Finansijski sporazum postignut prema ovom stavu odobrava i potpisuje ministar.</p>

